

**Pasqyrat financiare PIK Creative  
dhe Shënimet Shpjeguese  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018**

PIK Creative Shpk  
L12316016A  
Rruga Pjetër Bogdani, Nr. 37  
PASQYRA FINANCIARE 2018

## **PËRMBAJTJA**

|                                                    | <b>FAQJA</b> |
|----------------------------------------------------|--------------|
| <b>PASQYRAT FINANCIARE:</b>                        |              |
| <b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>              | <b>3</b>     |
| <b>PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE</b>         | <b>4</b>     |
| <b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR</b> | <b>5</b>     |
| <b>PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË</b>               | <b>6</b>     |
| <b>SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE</b>             | <b>7-17</b>  |
| <b>PASQYRA STATISTIKORE</b>                        | <b>18-19</b> |

**Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë shprehur në LEK)*

|                                          | Shenime | Më 31 dhjetor<br>2018 | Më 31 dhjetor<br>2017 |
|------------------------------------------|---------|-----------------------|-----------------------|
| <b>AKTIVET</b>                           |         |                       |                       |
| <b>Aktive afatshkurtra</b>               |         |                       |                       |
| Mjete monetare                           | 4       | 5,073,810             | 5,674,132             |
| Kërkesa për arkëtim tregtare             | 5       | 12,712,319            | 6,427,992             |
| Kërkesa për arkëtim tatimore             | 6       | 1,382                 | 276,138               |
| Të tjera kërkesa për arkëtim             | 7       | 7,057,401             | 5,681,431             |
| Inventarë                                | 8       | -                     | -                     |
| Parapagime dhe shpenzime të shtyra       | 9       | 10,023,703            | 8,953,073             |
| <b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>    |         | <b>34,868,615</b>     | <b>27,012,766</b>     |
| <b>Aktive afatgjata</b>                  |         |                       |                       |
| Aktive afatgjata materiale               | 10      | 1,333,641             | 1,432,645             |
| Aktivitet materiale jomateriale          |         | -                     | -                     |
| <b>Totali i aktiveve afatgjata</b>       |         | <b>1,333,641</b>      | <b>1,432,650</b>      |
| <b>Totali i aktiveve</b>                 |         | <b>36,202,256</b>     | <b>28,445,416</b>     |
| <b>DETYRIMET</b>                         |         |                       |                       |
| <b>Detyrimet afatshkurtra</b>            |         |                       |                       |
| Llogari të pagueshme tregtare            | 11      | 8,768,738             | 3,405,476             |
| Detyrime tatimore                        | 12      | 2,613,643             | 1,890,325             |
| Të tjera detyrime                        | 13      | 807,426               | -                     |
| <b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>  |         | <b>12,189,807</b>     | <b>5,295,801</b>      |
| <b>Detyrimet afatgjata</b>               |         |                       |                       |
| Detyrime financiare – afatgjata          |         | -                     | -                     |
| Detyrime tatimore të shtyra              |         | -                     | -                     |
| <b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>     |         | <b>-</b>              | <b>-</b>              |
| <b>KAPITALI</b>                          |         |                       |                       |
| Kapitali i nënshkruar                    | 14      | 100                   | 100                   |
| Fitim / Humbje të mbartura               | 14      | 23,149,515            | 22,632,935            |
| Fitim / Humbje Ushtrimore                | 14      | 862,834               | 516,580               |
| <b>Totali i kapitalit</b>                |         | <b>24,012,449</b>     | <b>23,149,615</b>     |
| <b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b> |         | <b>36,202,256</b>     | <b>28,445,416</b>     |

*Shënimet shpjeguese në faqet 7- 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

## Pasqyra e Performancës Financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë shprehur në LEK)

|                                                                 | Shënime | Për vitin e mbyllur<br>më 31 dhjetor 2018 | Për vitin e mbyllur<br>më 31 dhjetor 2017 |
|-----------------------------------------------------------------|---------|-------------------------------------------|-------------------------------------------|
| <b>I. Të ardhurat</b>                                           |         |                                           |                                           |
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit                        | 15      | 68,082,178                                | 79,449,375                                |
| Të ardhura të tjera                                             |         | -                                         | -                                         |
| <b>Total të Ardhurat (I)</b>                                    |         | <b>68,082,178</b>                         | <b>79,449,375</b>                         |
| <b>II. Shpenzime</b>                                            |         |                                           |                                           |
| Shpenzime direkte për mallrat dhe shërbimet e realizuara        | 16      | (38,225,385)                              | (51,423,227)                              |
| Shpenzime të personelit                                         | 17      | (22,385,683)                              | (19,932,235)                              |
| Shpenzime të përgjithshme dhe administrative                    | 18      | (4,122,937)                               | (5,290,583)                               |
| Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale                      | 10      | (414,971)                                 | (416,759)                                 |
| Shpenzime të tjera të shfrytëzimit                              | 18      | (891,050)                                 | (879,934)                                 |
| <b>Total shpenzimet</b>                                         |         | <b>(66,040,026)</b>                       | <b>(77,942,738)</b>                       |
| <b>Fitim Humbja nga veprimtaritë kryesore (I+II)</b>            |         | <b>2,042,152</b>                          | <b>1,506,636</b>                          |
| <b>III. Të ardhura dhe shpenzime financiare</b>                 |         |                                           |                                           |
| Të ardhura dhe shpenzime nga interesat                          | 19      | (51,951)                                  | (182)                                     |
| Të ardhura dhe shpenzime nga kurset e këmbimit                  | 19      | (380,469)                                 | (93,090)                                  |
| Komisione Banke                                                 | 19      | (234,631)                                 | (160,861)                                 |
| <b>Të ardhura (shpenzime) financiare neto (III)</b>             |         | <b>(667,051)</b>                          | <b>(254,133)</b>                          |
| <b>Fitimi para tatimit (I+II+III)</b>                           |         | <b>1,375,101</b>                          | <b>1,252,504</b>                          |
| Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin                          | 20      | (512,267)                                 | (735,924)                                 |
| <b>Fitimi (Humbja) e Vitit</b>                                  |         | <b>862,834</b>                            | <b>516,580</b>                            |
| <b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:</b>                   |         |                                           |                                           |
| Diferencat e këmbimit në përkthimin e operacioneve të huaja     |         |                                           |                                           |
| Fitim/(humbje) në rivlerësimin e pronës                         |         |                                           |                                           |
| Fitim/(humbje) në aktivet financiare të disponueshme për shitje |         |                                           |                                           |
| Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjeve         |         |                                           |                                           |
| Të ardhura të tjera totale gjithëpërfshirëse për vitin          |         |                                           |                                           |
| <b>Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin</b>                   |         |                                           |                                           |
| <b>Fitim/(humbje) i atribueshem për:</b>                        |         |                                           |                                           |
| Pronarët e shoqërise mëmë                                       |         | 862,834                                   | 516,580                                   |
| Interesa jo-kontrolluese                                        |         |                                           |                                           |
| <b>Fitimi/(humbja) për vitin</b>                                |         | <b>862,834</b>                            | <b>516,580</b>                            |
| <b>Të ardhura/(humbje) totale të atribueshme për:</b>           |         |                                           |                                           |
| Pronarët e shoqërise mëmë                                       |         | 862,834                                   | 516,580                                   |
| Interesa jo-kontrolluese                                        |         |                                           |                                           |
| <b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>        |         | <b>862,834</b>                            | <b>516,580</b>                            |

Shënimet shpjeguese në faqet 7-17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Ndryshimeve të Kapitalit për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018**

*(Vlerat janë shprehur në LEK)*

|                                                | Kapitali i<br>regjistruar | Rezerve<br>ligjore | Rezerva<br>te tjera | Rezerva e<br>rivleresimit | Fitime te<br>mbajtura | TOTAL      |
|------------------------------------------------|---------------------------|--------------------|---------------------|---------------------------|-----------------------|------------|
| <b>Balanca e hapjes</b>                        |                           |                    |                     |                           |                       |            |
| <b>Më 01 Janar 2017</b>                        | 100                       | -                  | -                   | -                         | 22,632,936            | 22,633,036 |
| Fitimi/(Humbja) e vitit                        | -                         | -                  | -                   | -                         | 516,580               | 516,580    |
| Shtim Kapitali                                 | -                         | -                  | -                   | -                         | -                     | -          |
| <b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b> | 100                       | -                  | -                   | -                         | 23,149,515            | 23,149,615 |
| Transferim në rezervë                          | -                         | -                  | -                   | -                         | -                     | -          |
| Dividend të paguar                             | -                         | -                  | -                   | -                         | -                     | -          |
| <b>Më 31 Dhjetor 2017</b>                      | 100                       |                    |                     |                           | 23,149,515            | 23,149,615 |
| <b>Më 01 Janar 2018</b>                        |                           |                    |                     |                           |                       |            |
| <b>Më 01 Janar 2018</b>                        | 100                       | -                  | -                   | -                         | 23,149,515            | 23,149,615 |
| Fitimi/(Humbja) e vitit                        | -                         | -                  | -                   | -                         | 862,834               | 862,834    |
| Shtim Kapitali                                 | -                         | -                  | -                   | -                         | -                     | -          |
| <b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b> | 100                       | -                  | -                   | -                         | 24,012,349            | 24,012,449 |
| Transferim në rezervë                          | -                         | -                  | -                   | -                         | -                     | -          |
| Dividend të paguar                             | -                         | -                  | -                   | -                         | -                     | -          |
| <b>Më 31 Dhjetor 2018</b>                      | 100                       | -                  | -                   | -                         | 24,012,349            | 24,012,449 |

*Shënimet shpjeguese në faqet 7 - 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

## Pasqyra e Ndryshimit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë shprehur në LEK)

|                                                              | Për vitin e mbyllur<br>më 31 dhjetor 2018 | Për vitin e mbyllur<br>më 31 dhjetor 2017 |
|--------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|-------------------------------------------|
| <b>Flukse monetare nga veprimtari shfrytëzuese:</b>          |                                           |                                           |
| Fitimi para tatimit                                          | 1,375,101                                 | 1,252,504                                 |
| <i>Rregullime për:</i>                                       |                                           |                                           |
| Amortizimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale  | 414,971                                   | 416,759                                   |
| Humbjen nga kembimet valutore                                |                                           |                                           |
| Të ardhurat nga interesi                                     |                                           |                                           |
| Shpenzimet për interesa                                      |                                           |                                           |
| Shpenzimet për Tatim fitim                                   | (512,267)                                 | (735,924)                                 |
| <i>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues</i>  | <u>1,277,805</u>                          | <u>933,339</u>                            |
| <br>Zvogëlimi / (rritja) e inventarëve                       | -                                         | -                                         |
| Zvogëlimi / (rritja) e kërkesave për arkëtim                 | (8,456,171)                               | 5,390,464                                 |
| (Zvogëlimi) / rritja e llogarive të pagueshme                | 6,894,006                                 | (6,976,424)                               |
|                                                              | <u>(1,562,165)</u>                        | <u>(1,585,960)</u>                        |
| <br>Interes i paguar                                         |                                           |                                           |
| Interes i arkëtuar                                           |                                           |                                           |
| Tatim fitimi i paguar                                        |                                           | (386,516)                                 |
| <b>Paraja neto nga aktivitetet operative</b>                 | <u>(284,360)</u>                          | <u>(1,039,138)</u>                        |
| <br><b>Flukse monetare nga veprimtaritë investuese:</b>      |                                           |                                           |
| Blerje e aktiveve afatgjata materiale                        | (315,963)                                 | (183,317)                                 |
| Blerje e aktiveve afatgjata jo-materiale                     |                                           |                                           |
| Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale           |                                           |                                           |
| <b>Paraja neto nga aktivitetet investuese</b>                | <u>(315,963)</u>                          | <u>(183,317)</u>                          |
| <br><b>Flukse monetare nga veprimtaritë financuese:</b>      |                                           |                                           |
| Arkëtime nga derdhja e kapitalit                             |                                           |                                           |
| Arkëtime nga huamarrjet dhe qiratë financiare                |                                           |                                           |
| Pagese për huamarrjet dhe qiratë financiare                  |                                           |                                           |
| Pagese Dividendi                                             |                                           |                                           |
| <b>Paraja neto veprimtaritë financuese</b>                   | <u>-</u>                                  | <u>-</u>                                  |
| <br><b>Pakësimi neto i mjeteve monetare</b>                  | <u>(600,323)</u>                          | <u>(1,222,454)</u>                        |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit      | 5,674,133                                 | 6,896,587                                 |
| <b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit</b> | <u>5,073,810</u>                          | <u>5,674,133</u>                          |

Shënimet shpjeguese në faqet 7 - 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Administratori

Alban Fejzaj



## Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë shprehur në LEK)

### 1. Informacion i përgjithshëm

PIK CREATIVE sh.p.k. (referuar si “PIK” ose “Shoqëria”) është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) më datë 16 Nëntor 2011.

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 prill 2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe nga statuti i saj. Aktiviteti i Shoqërisë konsiston në ofrimin e shërbimeve grafike dizënjim, editori, dizënjim faqe web, grafike multimediale, fushata promovionale prodhimesh, fushata sociale, packaging, reklama, ilustrime, broshura, katalogje elektronike dhe aktivitete të tjera në fushën e grafike dizënjim. Shoqëria zotërohet 40 % nga ortakut Z. Alban Fezaj, 20 % nga ortakut Z. Ardit Koleci, 40 % nga ortakut Z. Ilir Daci. Vlera e kapitalit themeltar është 100 Lekë, e ndarë në 3 kuota. Administrator i Shoqërisë është Z. Alban Fezaj. Shoqëria disponon ambiente në Tiranë që ndodhen në rrugën Pjetër Bogdani, Nr. 37.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 është 18 (tetëmbëdhjetë).

### 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

#### 2.1 Përputhshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të shpallura me datë 15 qershor 2006 në përputhje me Ligjin 9228, datë 29 prill 2004 të ndryshuar me ligjin 9477, datë 9 shkurt 2006, dhe të përmirësuara në përputhje me Urdherin e Ministrit të Financave nr.64, datë 22.07.2014, në fuqi nga data 1 janar 2015 si edhe ndryshimet me efekt nga 01.01.2018.

#### 2.2 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë. Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 janë paraqitur duke u nisur nga supozimi se Shoqëria do të jetë në gjendje t'i arkëtojë dhe t'i shlyejë këto të drejta dhe detyrime gjatë rrjedhës normale të biznesit.

#### 2.3 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përfshirje të rasteve kur përcaktohet ndryshe.

#### Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

#### 2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

## Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë shprehur në LEK)

### 3. Politikat kontabël kryesore

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

#### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në fillim dhe në fund të periudhës. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit të përdorura në konvertimin e asetëve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj janë:

|           | 31 dhjetor 2018 | 31 dhjetor 2017 |
|-----------|-----------------|-----------------|
| Lëuro/Lek | 123.42          | 132.95          |

#### 3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë joderivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë joderivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç sa më poshtë. Për instrumentat e mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë joderivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Paraja dhe ekuivalentet e parasë*

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet.

## Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

*(Vlerat janë shprehur në LEK)*

Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### *Hua me interes të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Instrumentet financiare klasifikohen si asete afashkurtra me përjashtim të rasteve kur shoqëria ka një të drejtë pa kusht për ta shtyrë pagesën e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël për shkak ose të natyrës së tyre afatshkurtër ose të normës së interesit e cila i përafrohet normës së tregut.

## 3.3 Aktive të qëndrueshme jomateriale

Aktivet e qëndrueshme jomateriale që kanë një jetë të përcaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes së aktivit e zvogëluar me vlerën e tij të mbetur. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë lineare përgjatë jetës së aktivit.

## 3.4 Aktive të qëndrueshme materiale

### *Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin, nëse ka, dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

### *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të

## Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë shprehur në LEK)

besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

### *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga data e vënies në përdorim. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit të aktiveve afatgjata për periudhën 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

|                             |                          |     |
|-----------------------------|--------------------------|-----|
| Mobilje dhe orëndi          | Mbi vlerën kontabël neto | 20% |
| Pajisje dhe programe IT     | Mbi vlerën kontabël neto | 25% |
| Mjete transporti e të tjera | Mbi vlerën kontabël neto | 20% |

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

## 3.5 Zhvlerësimi

### *Aktivitetet financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohen të burojnë nga aktiviteti.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivitetin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### *Aktivitetet jofinanciare*

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ekzistojnë tregues të zhvlerësimit. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, vlera e rikuperueshme vlerësohet.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit ose e njësisë së gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## 3.6 Përfitimet e punonjësve

*Fondet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe pensione*

## Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

*(Vlerat janë shprehur në LEK)*

Bazuar në legjislacionin shqiptar, Shoqëria është e detyruar të paguajë në emër të punonjësve të saj kontribute të detyrueshme në një fond social të menaxhuar nga shteti. Pagesat dhe detyrimet e mbuluara nga Shoqëria njihen si shpenzime në periudhën të cilës ato i përkasin.

### 3.7 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

### 3.8 Njohja e të ardhurave

*Shitja e shërbimeve*

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

### 3.9 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare, huatë e dhëna dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.10 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyre. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zera të njohur direkt në kapital, rast në të cilin njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke përdorur normen tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshem për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyre lind nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me kërkesat e SKK dhe vlerave të njohura të këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

Alban Fejzaj  
Administrator



## Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë shprehur në LEK)

### 4. MJETET MONETARE

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

|                    | 31 dhjetor 2018  | 31 dhjetor 2017  |
|--------------------|------------------|------------------|
| Llogari rrjedhëse: |                  |                  |
| Lek                | 4,423,196        | 3,392,890        |
| Euro               | 319,552          | 1,548,222        |
|                    | <b>4,742,748</b> | <b>4,941,113</b> |
| Arka:              |                  |                  |
| Lek                | 331,062          | 733,020          |
| <b>TOTALI</b>      | <b>5,073,810</b> | <b>5,674,132</b> |

### 5. KËRKESA TË ARKETUESHME TREGTARE

Kërkesat e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

|               | 31 dhjetor 2018   | 31 dhjetor 2017  |
|---------------|-------------------|------------------|
| Klientë       | 12,712,319        | 6,427,992        |
| <b>TOTALI</b> | <b>12,712,319</b> | <b>6,427,992</b> |

### 6. KËRKESA TË ARKËTUESHME TATIMORE

Kërkesat e arkëtueshme tatimore më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

|                 | 31 dhjetor 2018 | 31 dhjetor 2017 |
|-----------------|-----------------|-----------------|
| Tatim fitim     | -               | 276,138         |
| Tatime te tjera | 1,382           | -               |
| <b>TOTALI</b>   | <b>1,382</b>    | <b>276,138</b>  |

### 7. TË TJERA KËRKESA PËR ARKËTIM

Zëri “ Të tjera kërkesa për arkëtim” më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

|                              | 31 dhjetor 2018  | 31 dhjetor 2017  |
|------------------------------|------------------|------------------|
| Të tjera kërkesa për arkëtim | 7,057,401        | 5,681,431        |
| <b>TOTALI</b>                | <b>7,057,401</b> | <b>5,681,431</b> |

### 8. INVENTARI

Për shkak të natyrës së aktiviteteve të kryera nga Shoqëria gjatë viteve 2018 dhe 2017, Shoqëria nuk ka gjendje inventari.

### 9. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

**Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë shprehur në LEK)*

|                     | 31 dhjetor 2018   | 31 dhjetor 2017  |
|---------------------|-------------------|------------------|
| Parapagime          | 280,773           | 1,775,391        |
| Shpenzime të shtyra | 9,742,930         | 7,177,682        |
| <b>TOTALI</b>       | <b>10,023,703</b> | <b>8,953,073</b> |

**10. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

|                                    | Pajisje zyre,<br>mobilitie | Pajisje<br>informatike | Totali i Aktiveve<br>Fikse |
|------------------------------------|----------------------------|------------------------|----------------------------|
| <b>AQT me kosto historike</b>      |                            |                        |                            |
| Teprica me 1 Janar, 2018           | 1,087,385                  | 2,262,135              | 3,349,520                  |
| Shtesa nga blerjet                 | 206,587                    | 109,376                | 315,963                    |
| Transferime nga zëra të tjerë      | -                          | -                      | -                          |
| <b>Teprica me 31 Dhjetor, 2018</b> | <b>1,293,972</b>           | <b>2,371,511</b>       | <b>3,665,483</b>           |
| <b>Amortizimi akumuluar</b>        |                            |                        |                            |
| Teprica me 1 Janar, 2018           | (603,366)                  | (1,313,505)            | (1,916,871)                |
| Shtesa e vitit                     | (138,748)                  | (276,223)              | (414,971)                  |
| Transferime nga zëra të tjerë      | -                          | -                      | -                          |
| <b>Teprica me 31 Dhjetor, 2018</b> | <b>(742,114)</b>           | <b>(1,589,728)</b>     | <b>(2,331,842)</b>         |
| <b>Balanca me 31 Dhjetor, 2018</b> | <b>551,858</b>             | <b>781,783</b>         | <b>1,333,641</b>           |

**11. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE**

Llogarite e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

|               | 31 dhjetor 2018  | 31 dhjetor 2017  |
|---------------|------------------|------------------|
| Furnitorë     | 8,768,738        | 3,405,476        |
| <b>TOTALI</b> | <b>8,768,738</b> | <b>3,405,476</b> |

**12. DETYRIME TATIMORE**

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

|                                     | 31 dhjetor 2018  | 31 dhjetor 2017  |
|-------------------------------------|------------------|------------------|
| Tatim mbi të ardhurat personale     | 344,699          | 177,139          |
| Sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 793,285          | 370,036          |
| TVSH                                | 1,107,235        | 1,327,673        |
| Tatim në burim                      | 309,839          | 15,477           |
| Detyrime per gjobat                 | 14,798           | -                |
| Tatim fitimi                        | 43,787           | -                |
| <b>TOTALI</b>                       | <b>2,613,643</b> | <b>1,890,325</b> |

**13. TË TJERA DETYRIME**

## Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë shprehur në LEK)

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

|                                   | 31 dhjetor 2018 | 31 dhjetor 2017 |
|-----------------------------------|-----------------|-----------------|
| Overdraft bankar Intesa SanPaolo  | 795,426         | -               |
| Shperblim nga sigurimet shoqerore | 12,000          | -               |
| <b>TOTALI</b>                     | <b>807,426</b>  | <b>-</b>        |

## 14. KAPITALI I NËNSHKRUAR

Kapitali i pronarit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

|               | 31 dhjetor 2018 | 31 dhjetor 2017 |
|---------------|-----------------|-----------------|
| Kapitali      | 100             | 100             |
| <b>TOTALI</b> | <b>100</b>      | <b>100</b>      |

## 15. TË ARDHURA

Shoqeria ka realizuar të ardhura gjatë vitit 2018 të lidhura me aktivitetin e saj. Shoqeria ka njohur të ardhurat atëherë kur ka konsideruar të mundshme që do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmeri. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera janë njohur në pasqyrat financiare kur ato kanë ndodhur (dhe jo kur para ja ose ekuivalentet e saj janë arketuar ose paguar) dhe janë njohur në kontabilitet e raportuar në pasqyrat financiare të periudhës kontabel, të cilave u perkasin.

Të ardhurat e shoqërisë gjatë vitit 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë vijon:

|                         | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2018 | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2017 |
|-------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Të ardhura nga shërbimi | 68,082,178                           | 79,449,375                           |
| <b>TOTALI</b>           | <b>68,082,178</b>                    | <b>79,449,375</b>                    |

Të ardhurat ndahen sipas shërbimeve kryesore të realizuara nga shoqëria gjatë vitit 2018:

|                                             |                   |                   |
|---------------------------------------------|-------------------|-------------------|
| Shërbime (fatura) të lëshuara në Janar 2019 | 2,607,980         | 1,524,994         |
| Shitje shërbime Kreative                    | 15,026,079        | 23,622,513        |
| Shitje shërbime Digital                     | 5,134,770         | 4,289,756         |
| Prodhime (production, printime etj.)        | 13,863,778        | 8,158,108         |
| Organizim Eventi                            | 15,449,909        | 19,622,111        |
| Prodhim Shitje Shërbime Audio Visual        | 8,594,792         | 15,770,362        |
| Shitje Media Buying                         | 2,698,205         | 5,822,566         |
| Shitje mallrash                             | 4,706,665         | 638,965           |
| <b>TOTAL</b>                                | <b>68,082,178</b> | <b>79,449,375</b> |

## Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë shprehur në LEK)

### Rakordim i shifrës së afarizmit me FDP

| I. Deklarimi sipas Librave (FDP)                     |                       |
|------------------------------------------------------|-----------------------|
| Shitje të tatueshme                                  | 63,360,859.10         |
| Shitje pa TVSH                                       | 3,638,380.21          |
| Shitje të përjashtuara                               | -                     |
| <b>TOTAL</b>                                         | <b>66,999,239.31</b>  |
| II. Deklarimi sipas PF 2018                          |                       |
| Të ardhura nga sherbimi                              | 68,082,178.62         |
| Të ardhura të tjera                                  | -                     |
| <b>TOTAL</b>                                         | <b>68,082,178.62</b>  |
| <b>DIFERENCA I-II</b>                                | <b>(1,082,939.31)</b> |
| RAKORDIM DIFERENCA                                   |                       |
| - Të ardhura të njohura në 2017 të deklaruar në 2018 | (1,524,994)           |
| + Të ardhura të njohura në 2017 të deklaruar në 2019 | 2,607,980             |
| Rrumbullakosje                                       | (47)                  |
| <b>TOTAL</b>                                         | <b>1,082,939</b>      |

## 16. LËNDË E PARË DHE MATERIALE TË KONSUMUESHME

Lënda e parë dhe materialet e konsumueshme që lidhen direkt me të ardhurat e përfituara gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

|                              | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2018 | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2017 |
|------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Kosto e mallit të shitur     | 3,579,359                            | 563,880                              |
| Shërbime design dhe kreative | 3,784,827                            | 7,791,270                            |
| Shërbime organizim event     | 12,302,432                           | 14,286,908                           |
| Shërbime dixhitale           | 1,444,783                            | 3,759,256                            |
| Shërbime printi dhe prodhime | 9,126,151                            | 9,547,520                            |
| Shërbime realizime video     | 5,785,548                            | 11,114,972                           |
| Shërbime media               | 2,202,285                            | 4,359,422                            |
| <b>TOTALI</b>                | <b>38,225,385</b>                    | <b>51,423,227</b>                    |

## 17. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhet si më poshtë:

|                                                   | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2018 | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2017 |
|---------------------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Pagat e personelit                                | 19,631,781                           | 17,560,616                           |
| Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 2,753,902                            | 2,371,619                            |
| <b>TOTALI</b>                                     | <b>22,385,683</b>                    | <b>19,932,235</b>                    |

**Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë shprehur në LEK)***18. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE**

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

|                                      | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2018 | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2017 |
|--------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Blerje, energji, avull, ujë          | 322,214                              | 288,949                              |
| Shpenzime Qira                       | 2,636,288                            | 2,655,741                            |
| Shërbime Noteriale dhe përkthimi     | 85,100                               | 49,124                               |
| Shërbime Interneti                   | 198,750                              | 204,750                              |
| Shërbim sigurie                      | 60,000                               | 60,000                               |
| Shërbim sigurimi                     | 7,600                                | 4,000                                |
| Shërbim IT                           | 120,586                              | 815,341                              |
| Shpenzime Kancelarike                | 55,361                               | 170,047                              |
| Shërbim konsulence                   | 250,000                              | 479,926                              |
| Transferime, udhëtime, dieta         | 141,959                              | 269,003                              |
| Shpenzime postare dhe telekomunikimi | 245,079                              | 293,702                              |
| <b>TOTALI</b>                        | <b>4,122,937</b>                     | <b>5,290,583</b>                     |

Shpenzimet e tjera gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

|                                                   | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2018 | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2017 |
|---------------------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Shpenzime për pritje dhe përfaqësim               | 361,816                              | 296,353                              |
| Shpenzime transporti                              | 16,710                               | 58,680                               |
| Blerje/Shpenzime të tjera (kafe, detergjente etj) | 283,797                              | 373,183                              |
| Taksa, tarifa dhe komisione doganore              | 11,271                               | 7,995                                |
| Taksa dhe tarifa vendore                          | 67,000                               | 128,000                              |
| Gjoka dhe penalitete                              | 37,907                               | 7,525                                |
| Shpenzime të tjera                                | 112,549                              | 8,200                                |
| <b>TOTALI</b>                                     | <b>891,050</b>                       | <b>879,934</b>                       |

**19. TË ARDHURA (SHPENZIME) FINANCIARE, NETO**

Të ardhurat (shpenzimet) financiare gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

|                                         | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2018 | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2017 |
|-----------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Të ardhura nga interesa                 | 33                                   | 0                                    |
| Shpenzime për interesa                  | (51,984)                             | (182)                                |
|                                         | <b>(51,951)</b>                      | <b>(182)</b>                         |
| Fitime të realizuara nga kursi kembimit | 330,915                              | 302,165                              |
| Humbje të realizuara nga kursi kembimit | (711,384)                            | (395,255)                            |
|                                         | <b>(380,469)</b>                     | <b>(93,090)</b>                      |
| Komisione bankare                       | (234,631)                            | (160,861)                            |
| <b>TOTALI</b>                           | <b>(667,051)</b>                     | <b>(254,133)</b>                     |

## Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë shprehur në LEK)

### 20. TATIM- FITIMI

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyre. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje përveç nese lidhet me zera të njohur direkt në kapital, rast në të cilin njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke përdorur normen tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshem për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyre lind nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me kërkesat e SKK dhe vlerave të njohura të ketyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15 % për vitin 2018.


|                                                  | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2018 | Viti i mbyllur më<br>31 dhjetor 2017 |
|--------------------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Fitimi (humbja) kontabël e vitit                 | 1,375,101                            | 1,252,503                            |
| Rregullime për zëra shpenzimesh të panjohura:    | 2,040,010                            | 3,653,657                            |
| <b>Fitimi (humbja) fiskale e vitit</b>           | <b>3,415,111</b>                     | <b>4,906,161</b>                     |
| Shpenzime të Tatim fitimit 2018                  | (512,267)                            | (735,924)                            |
| <b>Fitimi (humbja) fiskale e vitit neto</b>      | <b>2,902,844</b>                     | <b>4,170,237</b>                     |
| Parapagim tatim fitim                            | 468,480                              | 955,902                              |
| <b>Balanca TF për vitin pasardhës/për pagesë</b> | <b>(43,787)</b>                      | <b>219,978</b>                       |

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të adhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe bëjnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritet tatimore. Për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, Shoqëria ka rezultuar me fitim kontabël dhe fiskal.

Viti i mbyllur më Viti i mbyllur më  
31 dhjetor 2018 31 dhjetor 2017

|               |                  |                  |
|---------------|------------------|------------------|
| Tatim-fitimi  | (512,267)        | (735,924)        |
| <b>TOTALI</b> | <b>(512,267)</b> | <b>(735,924)</b> |

Këto pasqyra financiare u aprovuan dhe u nënshkruan nga Drejtimi i Shoqërisë më 05 mars 2019:

Administrator  
Alban Fejzaj  
  


**Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë shprehur në LEK)***Aktivët Afatgjatë Materiale me vlerë fillestare 2018**

| Nr            | Emërtimi                  | Gjendje<br>01/01/2018 | Shtesa         | Pakesime | Gjendje<br>31/12/2018 |
|---------------|---------------------------|-----------------------|----------------|----------|-----------------------|
| 1             | Toka                      |                       |                |          |                       |
| 2             | Ndërtime                  |                       |                |          |                       |
| 3             | Makineri,paisje Instalime |                       |                |          |                       |
| 4             | Mjete transporti          |                       |                |          |                       |
| 5             | Mobilje Orendi            | 1,087,385             | 206,587        |          | 1,293,972             |
| 6             | Paisje Informatike        | 2,262,135             | 109,376        |          | 2,371,511             |
| <b>TOTALI</b> |                           | <b>3,349,520</b>      | <b>315,963</b> | <b>0</b> | <b>3,665,483</b>      |

**Amortizimi A.A.Materiale 2018**

| Nr            | Emërtimi                  | Gjendje<br>01/01/2018 | Shtesa         | Pakesime | Gjendje<br>31/12/2018 |
|---------------|---------------------------|-----------------------|----------------|----------|-----------------------|
| 1             | Toka                      |                       |                |          |                       |
| 2             | Ndërtime                  |                       |                |          |                       |
| 3             | Makineri,paisje Instalime |                       |                |          |                       |
| 4             | Mjete transporti          |                       |                |          |                       |
| 5             | Mobilje Orendi            | 603,366               | 138,748        |          | 742,114               |
| 6             | Paisje Informatike        | 1,313,505             | 276,223        |          | 1,589,728             |
| <b>TOTALI</b> |                           | <b>1,916,871</b>      | <b>414,971</b> | <b>0</b> | <b>2,331,842</b>      |

**Vlera Kontabël Neto e A.A.Materiale 2018**

| Nr            | Emërtimi                  | Gjendje<br>01/01/2018 | Shtesa         | Pakesime | Gjendje<br>31/12/2018 |
|---------------|---------------------------|-----------------------|----------------|----------|-----------------------|
| 1             | Toka                      |                       |                |          |                       |
| 2             | Ndërtime                  |                       |                |          |                       |
| 3             | Makineri,paisje Instalime |                       |                |          |                       |
| 4             | Mjete transporti          |                       |                |          |                       |
| 5             | Mobilje Orendi            | 484,019               | 67,839         |          | 551,858               |
| 6             | Paisje Informatike        | 948,630               | - 166,847      |          | 781,783               |
| <b>TOTALI</b> |                           | <b>1,432,649</b>      | <b>-99,008</b> | <b>0</b> | <b>1,333,641</b>      |

**Administratori****Alban Fejzaj**

Alban Fejzaj



**Shënimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

*(Vlerat janë shprehur në LEK)*

**Shoqëria PIK Creative Shpk**  
**NIPT L12316016A**

Inventari automjeteve në pronësi të subjektit 2018

| Nr.   | Lloji automjetit | Kapaciteti | Targa | Vlera e mbetur |
|-------|------------------|------------|-------|----------------|
|       |                  |            |       |                |
|       |                  |            |       |                |
|       |                  |            |       |                |
| Shuma |                  |            |       |                |

**Shoqëria PIK Creative Shpk**  
**NIPT L12316016A**

Inventari në pronësi të subjektit 2018

| Nr.   | Lloji i mallit | Copë | Cmimi | Vlera |
|-------|----------------|------|-------|-------|
|       |                |      |       |       |
|       |                |      |       |       |
| Shuma |                |      |       |       |

Këto pasqyra financiare janë nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë, më 05 mars 2019.

Administrator  
Alban Fejzaj

*Alban Fejzaj*

